Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/519
Datë 14.12.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 14.12.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin dhe validimin e Qendrës për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi", Gjakovë për periudhën: 14.12.2015 deri 14.12.2018 për të ofruar:

   1.1 Teknologji ushqimore me profilin: Përpunues i Qumështit.

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të ndahet një hapësirë për punëtorinë profesionale praktike për përpunim të qumështit dhe pajisja e saj me mjete teknologjike profesionale si: frigorifer, laktofriz, duplikator, homogjenizator, shtypës manual apo me presion automatik, makinë për ambalazhim të qumështit apo prodhimeve nga qumështi, kada (vaska) për prodhimin e djathit me mjetet përcjellëse, bidonë nga çeliku i pakoroduar (inox), elemente tjera inox si: tavolina, thika, enë për dhënien e formave të prodhimeve nga qumështi, kulluese për qumësht (mjete për filtrim të qumështit para përpunimit), që do t'i përmbushnin kërkesat minimale bazuar në standardet e profesionit.
- Të sigurohet hapësira e ndarë fizike për laboratorët e Kimisë, Mikrobiologjisë-Sigurisë ushqimore dhe mjetet konkretizuese si: materiale shpenzuese didaktike, mjete higjienike laboratorike, pajisje laboratorike si: epruveta, pipeta, bireta, banjo ujore, dorëza higjienike, homogjenizator profesional laboratorik, termostat, autoklav, destilator i ujit etj., bazuar në kërkesat e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojnë laboratorët për zhvillimin e aktivitetit praktik.

- Të sigurohen hapësira (punëtori) për realizimin e pjesës praktike për nivelin e parë të aftësimit në : Teknologjinë e mishit, prodhimeve furrtare, përpunimit dhe konservimit të frutave dhe perimeve.
- Të lidhen kontrata bashkëpunimi me Kompanitë e ndryshme ushqimore të profilit të përpunimit të ushqimeve si: Përpunues të mishit, prodhimeve furrtare, përpunimit dhe konservimit të pemëve dhe perimeve.
- Të ofrohen certifikata të nivelit të tretë, pas përfundimit të klasës së 10 dhe 11, me anë të të cilave nxënësi merr thirrjen: Punëtor gjysmë i kualifikuar, bazuar në KKK.
- Të ofrohen dëshmi për mbulesën financiare mbi organizimin (transportin) dhe vijueshmërinë e kandidatëve në aftësimin praktik (nga kush mbulohen shpenzimet, nga vetë kandidati, biznesi apo QAKP? Si është planifikuar?!).
- (Afati kohor i këtyre kushteve: 30.11.2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Qendrës për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi" , Gjakovë;
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani